

V E N D I M
Nr.64, datë 3.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci, Anëtar i “““

Gjergj Sauli, Anëtar i “““

Alfred Karamuco, Anëtar i “““

Kristofor Peçi, Anëtar i “““

Kujtim Puto, Anëtar i “““

Petrit Plloçi, Anëtar i “““

Tefta Zaka, Anëtare e “““

Sokol Sadushi, Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 3.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.68 Akti që i përket:

KËRKUES: DURIM HUSHI, kandidat për deputet i Partisë Socialiste, përfaqësuar nga avokat Ilia Olldashi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

2. OMER STRINGA, kandidat për deputet i koalicionit Bashkimi për Fitore.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.925, datë 27.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpallja fitues e kandidatit Durim Hushi.

Kërkuesi për shfuqizimin e vendimit nr.925, datë 27.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka parashtruar këto shkaqe:

- Në qendrat e votimit nr.49 dhe 51 të zonës zgjedhore nr.50, komisionet e qendrave të votimit kanë shpallur në rezultatet e votimit respektivisht 184 dhe 22 vota të pavlefshme në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor, ndërkohë që këto vota kanë qenë të vlefshme dhe në favor të kërkuesit.

- Qytetarëve u është mohuar e drejta kushtetuese politike e votës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, subjektet e interesuara, si dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.925, datë 27.6.2001 ka shpallur rezultatin e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore nr.50 duke mos njohur fitues asnjë kandidat për deputet, si dhe zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve në këtë zonë më datën 8 korrik 2001 ndërmjet kandidatit për deputet të Partisë Socialiste, zotit Durim Hushi dhe kandidatit të koalicionit Bashkimi për Fitore, zotit Omer Stringa.

Në raundin e parë të zgjedhjeve kërkuesi Durim Hushi ka marrë 5 253 vota, ose 49,06% dhe zoti Omer Stringa ka marrë 4 354 vota ose 40,66%. Në bazë të nenit 63 të Kodit Zgjedhor asnjëri nga kandidatët për deputet nuk ka arritur të sigurojë shumicën absolute të votave të vlefshme të zgjedhësve, që rezultojnë 10 707 sipas Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.50.

Kërkuesi ka pretenduar se 206 vota të pavlefshme të shpallura padrejtësisht nga komisionet e qendrave të votimit nr.49 dhe 51, nëse do të rezultonin në favor të tij, atëherë ai do të shpallej fitues që në raundin e parë, pasi e realizoi shumicën absolute të votave të vlefshme.

Në këto kushte, meqënëse pretendimi i kërkuesit lidhej drejtpërdrejt me vendimin e shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Gjykata Kushtetuese vendosi, në bazë të nenit 107 pika 2 të

Kodit Zgjedhor të urdhërojë, hapjen e kutive të votimit të qendrave të votimit nr.49 dhe 51 të Zonës Zgjedhore nr.50.

Fillimisht u hap kutia e votimit që i përkiste qendrës së votimit nr.49. Nga verifikimi i 184 votave të shpallura si të pavlefshme nga komisioni i kësaj qendre votimi rezultuan se 19 vota ishin të pavlefshme, ndërsa diferenca prej 165 votash u konsideruan të vlefshme nga Gjykata Kushtetuese. Për kërkesin Durim Hushi rezultuan 97 vota të vlefshme, ndërsa për kandidatin e koalicionit Bashkimi për Fitore Omer Stringa 53 vota. Duke i shtuar numrit të votave 5 253 që kërkesi ka marrë në raundin e parë të zgjedhjeve shifrën 97 të rivlerësuar pas hapjes së kutive si vota të vlefshme në favor të tij, rezultoi se kërkesi nuk arrinte shumicën absolute të votave për t'u shpallur fitues që në raundin e parë. Meqenëse në kutinë e qendrës së votimit nr.51 kishte 22 vota të pavlefshme, shifër e cila nuk influenconte në ndryshimin e rezultatit, Gjykata Kushtetuese e konsideroi të panevojshëm vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së verifikimit të votave.

Nga sa më lart, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se vendimi nr.925, datë 27.6.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që nuk kishte shpallur asnjë fitues dhe kishte vendosur zhvillimin e raundit të dytë midis tyre nuk duhej shfuqizuar.

Gjithashtu, lidhur me fuqinë e vendimit të saj, Gjykata Kushtetuese konkludon se duhet të zbatohet nenin 26 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “e” dhe 132 të Kushtetutës, si dhe në nenet 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.